



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR

Nr. 510 Prot
11

Datë 14 / 07 / 2022

NJOFTIM

Në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit nr.140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të TKOBAP”; Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i RSH”, i ndryshuar; Ligjit nr. 90 dt.27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; Ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambli Popullor (TKOBAP) shpall konkurrimin për 1 (një) vend të lirë në pozicionin:

Mjeshtër Skene

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme, dhe kërkesat e veçanta si më poshtë:

- Të këtë arsim të mesëm të përgjithshëm ose profesional;
- Të këtë përvojë pune mbi 10 vjet në realizimin dhe montimin e dekoreve të shfaqjeve;
- Të këtë njohuri shumë të mira të vizatimit teknik, zbërthimin në detaje të vizatimeve;
- Të njohë makineritë dhe mjetet e tjera të punës të cilat kanë të bëjnë me realizimin e dekoreve, të njohë materialet që kanë të bëjnë me drurin etj;
- Të zbatojë me përpikmëri (skicat teknike) të shfaqjes të lidhura ngushtë me profilin e punës;
- Të organizojë punën, ndarjen e punës të teknikëve të skenës;
- Të kryejë të gjitha përgatitjet e nevojshme për punën e tij.
- Të zbatojë rregullat e etikës në administratën publike.
- Të këtë aftësi të mira komunikimi, si dhe i aftë për të punuar në grup.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

1. Kërkesë me shkrim për pozicionin e punës së shpallur;
2. Jetëshkrimi CV;
3. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
4. Fotokopje e diplomës dhe e listës së notave të noterizuara;
5. Dokument për kualifikime, dëshmi trajnimesh të ndryshme, etj (nëse ka) ;
6. Fotokopje të librezës së punës;
7. Dëshmi e gjëndjes gjyqësore;
8. Një numër telefoni si dhe adresa e plotë të vendbanimit;

*Dokumentat duhen të paraqiten në gjuhën shqipe.

Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell skualifikim te kandidatit.

KONKURIMI: Është i hapur

Dokumentacioni do të dorëzohet pranë sekretarisë së TKOBAP(zyra e protokollit) ose të skanuara në mailin zyrtar të TKOBAP-së sekretaria@tkob.gov.al deri me datë 29/ 07/ 2022.Pas verifikimit të dokumentave të kërkuara, në Teatrin Kombëtar të Operas Baletit dhe Ansamblit Popullor, kandidatët të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara do të lajmërohen nepërmjet numrit të tyre të kontaktit ose mail nga Sekretaria e Institucionit, për intervistën e strukturuar me gojë.

Të gjitha njoftimet për shpalljet e vendeve të lira, si dhe data kur do të shpallet fituesi, mund ti gjeni në faqen zyrtare të ëeb-it të Teatrit Kombëtar të Operas Baletit dhe Ansamblit Popullor www.tkob.gov.al; faqja zyrtare e Agjensisë së Prokurimit Publik www.app.gov.al.

DREJTORE e PËRGJITHSHME

Abigeila VOSHTINA



Konceptoi: Juriste Migena Biba